



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. Prot. 3680

Tiranë, më 4.07.2017

LËNDA: Kërkesë për dërgimin e Raportit Përfundimtar të monitorimit në zbatim të VKM nr.473/2017

DREJTUAR: Të gjitha ministrive

Të nderuar,

Nga zyra e Zëvendëskryeministrit janë administruar informacionet e deritanishme të sjella nga institucionet Tuaja në zbatim të VKM nr. 473, datë 01.06.2017 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë”.

Në funksion të hartimit të Raportit Përfundimtar nga Task – Forca, Ju kërkoj që brenda ditës së hënë datë 10 korrik 2017 të dërgoni në adresë të Zëvendëskryeministrit Raportin Përfundimtar nga ministria Juaj lidhur me punën e grupeve të monitorimit/inspektimit të ngritura në kuptim të pikës 30 të VKM nr.473/2017.

Në Raportin Përfundimtar të pasqyrohen në mënyrë të detajuar detyrat konkrete të përcaktuara nga ministri, mënyra apo metodologjia e përdorur nga grupet e monitorimit/inspektimit për kontrollin e zbatimit të këtyre detyrave dhe konstatimet/gjetjet nga grupet e monitorimit, duke iu referuar objektit të monitorimit sipas përcaktimeve të pikës 31 të VKM nr.473/2017, dhe përveç të tjerave duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në:

- Rastet e evidentuara (nëse ka) të dhënies së premtimeve, favoreve apo cënimit të të drejtave të shtetasve, si mekanizëm për favorizimin apo dhënien e votës një subjekti të caktuar politik.

- Rastet e evidentuara (nëse ka) të përdorimit gjatë procesit zgjedhor të mjeteve financiare nga burime të paligjshme apo të krijuara nga veprimtari të paligjshme.

Raporti në fjalë të jetë i konsoliduar për ministrinë dhe institucionet e varësisë së ministrisë duke përfshirë edhe ndërmarrjet apo shoqëritë shtetërore.

Raporti të dërgohet në formë shkresore dhe elektronike në adresën e emailit: Sonila.Balla@kryeministria.al.

Ju falënderoj për bashkëpunimin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

LEDINA MANDIJA

